



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 268/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 07.05.2019 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Modifikimi i dokumentave të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur”, me objekt “Menaxhimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve dhe operimi i Tunelit të Krrabës”, me nr. REF-12661-03-06-2019, me fond limit 194,920,000 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Ankimues: Operatori ekonomik “Ed-Konstruksion” sh.p.k.
Adresa: Rr. “Frederik Shiroka”, Nd.6, H.10, Ap.6, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Autoriteti Rrugor Shqiptar
Adresa: Rr. “Sami Frashëri”, Nr.33, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 08.03.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me objekt “*Menaxhimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve dhe operimi i Tunelit të Krrabës*”, me nr. REF-12661-03-06-2019, me fond limit 194,920,000 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

II.2. Në datën 13.03.2019, operatori ekonomik ankimues “Ed-Konstruksion” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e kritereve të procedurës së mësipërme të prokurimit, me argumentimin si më poshtë vijon:

“[...]Së pari: Pasi u njohëm me dokumentat e tenderit dhe specifikisht “*Kriteret për Kualifikim*” konsatuam se ato nuk përputhen me kriteret e kërkuara në “*Termat e Referencës*”. Në kërkesat për kualifikim të dokumentave të tenderit ndër të tjera kërkohet (21 punonjës):

e) Në Stafin kryesor kërkohen:

- 1 Menaxher Primar Drejtues për operimet në tunel/Oficer Sigurie: i diplomuar në inxhinieri transporti/infrastrukturë transporti
- 3 Operatorë primarë tuneli: të diplomuar në inxhinieri mekanike/elektrike
- 1 përgjegjës të mirëmbajtjes së pajisjeve: i diplomuar në inxhinieri elektrike/ mekanike.

f)Në stafin jokryesor:

- Jo më pak se 6 operatorë tuneli, të diplomuar në inxhinieri elektrike /elektronike/ mekanike.
- Të paktën 20 punonjës të kualifikuar, të certifikuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik e Industrial ose institucione të tjera të akredituara, ndër të cilët së paku: 4 elektrikistë, 2 hidraulikë, 2 mekanikë, 3 manovratorë mjetesh të rënda, 7 shoferë, 2 specialistë për kondicionim/aspirim.
- Kandidati/ofertuesi duhet të dëshmojë se të paktën një nga drejtuesit teknikë është i pajisur me certifikatë si 'Ekspert privat zjarrfikës', të lëshuar nga Drejtoria e PMNZH (Ministria e Brendshme)

*Stafi i pikave d,e,f duhet të rezultojë i siguruar në listëpagesat e kërkuara.

Të paraqiten: diplomat/dëshmitë/certifikatat e sipërpërmendura dhe listëpagesat përpatëse.

Ndërkohë në termat e referencës kërkohet 37 punonjës :

Staf kyç në menaxhimin e tuneli , do të jenë:

-Një Menaxher Primar i Operimeve në Tunel / Oficer për Sigurinë duhet të ketë edukimin arsimor në inxhinieri transporti ose të infrastrukturës së transportit si dhe eksperiencë të paktën 5 vjeçare në sigurinë rrugore, veçanërisht në administrimin e incidenteve rrugore dhe inspektimin e sigurisë rrugore. Ai gjithashtu duhet të ketë njohuri për sistemet inteligjente të transportit që lidhen me administrimin e incidenteve e të aksidenteve rrugore

- Tre Operatorë Primarë Tuneli me edukim arsimor në inxhinieri mekanike, elektrike dhe eksperiencë të paktën 5 vjeçare në zhvillimin e shfrytëzimin e operacioneve në tunele rrugore dhe procedurave të mirëmbajtjes në to.

- Përgjegjës i Mirëmbajtjes së Pajisjeve, me arsimin inxhinieri elektrike ose mekanike, (me experiencë të mjaftueshme dhe të suksesshme në tunele e vepra të tjera të natyrës së ngjashme) i cili do jetë përgjegjës për të siguruar standartin e duhur të cilësisë së mirëmbajtjes të pajisjeve dhe sistemeve të tunelit.

–Menaxheri i Tunelit duhet të punesojë Staf të trajnuar, që të bëhen kështu gjashtë Operatorë Lokalë Tuneli. Kërkohet që stafi i trajnuar të ketë staf mbështetës për sistemin e punës me turne, por këta të fundit gjithmonë do drejtohen nga Menaxheri Primar Tunelit në detyrë dhe në kontroll të turnit operues të radhës.

Gjithashtu, Menaxheri i Tunelit duhet të ketë Staf Jo-Kryesor (mbështetës) minimalisht si më poshtë: •4 Teknikë Mirëmbajtje Pajisjesh, të kualifikuar mjaftueshëm dhe me eksperiencë, që do trajnohen dhe drejtohen nga Përgjegjësi i Mirëmbajtjes së Pajisjeve, gjatë rrjedhës së kontratës, sipas Planit të Sigurimit të Cilësisë së mirëmbajtjes së pajisjeve që do operojnë në tunel. •1 Menaxher Personeli i cili do të menaxhojë burimet njerëzore të Menaxherit të Tunelit si edhe financën e kësaj Kontratë; •1 Asistent në pozicionin e Sekretarit/ Magazinjer •4 Elektricitistë të specializuar të cilët do të operojnë nga 1 në çdo turn 8-orarësh dhe 1 do të jetë zëvendësues, për cdo situatë; •2 Mekanikë të specializuar të cilët do të mbulojnë situatat e pajisjeve mekanike të tunelit; •2 Hidraulikë të specializuar të cilët do të mbulojnë situatat në hidrantët dhe pajisjet e

tjera hidraulike të tunelit; 3 Shoferë për auto-vinc me kovë dhe karrotrec, nga 1 për çdo turn, • 8 shoferë për 4 kamionët pick-up apo fuoristrada të instaluar në tunel • 1 Pastruese për ambientet e Qëndres së Kontrollit;

Stafi mbështetës duhet të përfshihet në Ekipet e Mirëmbajtjes dhe Operimin të Tunelit. Kualifikimi dhe eksperiencia e stafit mbështetës duhet të prezantohet në Propozimin Teknik të Menaxherit të Tunelit, pavarësisht se stafi mund të mos limitohet në sasitë e përshkruara më sipër por edhe të zgjerohet më tej numrit të përcaktuar në kriteret. Megjithatë, insuficiencia e kualifikimit të nevojshëm të stafit mbështetës do të çojë edhe në refuzim të Propozimit Teknik. Menaxheri i Tunelit do përfshijë në Propozimin Financiar gjithë stafin e plotë të tij (si stafin kryesor dhe atë mbështetës). Menaxheri i Tunelit duhet të paraqesë detajet e stafit të tij për këtë Kontratë, sikurse është përcaktuar në Dokumentat e Tenderit. Ndërsa në preventivin në do të ofertohej në në termat e referencës kërkohet 37 punonjës...

Lidhur me sa më sipër duke qenë se: Referuar në nenin 28, pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, që përcakton se: - “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”. Referuar në nenin 63, pika 3, paragrafi i parë i tij, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, që përcakton se: - “Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim të përcaktuara në dokumentet e tenderit”. Kërkojmë nga Autoriteti Kontraktor unifikimin e kërkesave të veçanta për kualifikim me sa kërkuar në kërkesat e përcaktuara në termat e referencës, pasi jo vetëm që kjo mospërputhje është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për prokurimet publike por krijon konfuzion dhe paqartësi për mënyrën e ofertimit.

Së dyti: Në dokumentat e tenderit dhe specifikisht “Kriteret për Kualifikim” kërkohet: Kandidati ofertuesi duhet të dëshmojë se të paktën një nga drejtuesit teknikë është i pajisur me certifikatë si ‘Ekspert privat zjarrfikës’, të lëshuar nga Drejtoria e PMNZH (Ministria e Brendshme) Ndërkohë në në termat e referencës përcaktohet qartësisht si më poshtë vijon: Punëdhënësi ka vendosur marreveshje institucionale me Drejtorinë e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit për instalimin e njësisë së tyre (brigada e zjarrfikësve), të jetë përherë e instaluar në funksion të Tunelit. Kjo njësi është gjithë kohën në gjendje gadishmërie dhe e pajisur me gjithë elementët dhe kostot operuese të luftës kundër zjarrit në tunel, makinat zjarrfikëse, shkumën kundra zjarrit, fikëset e zjarrit dhe pjesë të tjera konsumi. (fq.14). Menaxheri i Tunelit do të koordinojë aktivitetet e tij me ato të shërbimit zjarrfikës lokal si dhe duke mbajtur kontakte me shërbimet e policisë së zonës, në mënyrë që dhe këto dy shërbime të tjera të veprojnë së bashku me Menaxherin e Tunelit si një njësi e bashkuar e cila do të jetë efektive në ndalimin e çdo mjeti mbi normat e lejuara, ose të pasigurtë në tunel, kontrollin e sigurtë të fluksit të trafikut dhe të përgatitur ndaj çdo situatë emergjente. (fq.4). Menaxheri i Tunelit, sikurse shpjegohet edhe më lart, do të sigurojë shërbimet e kërkuara të menaxhimit/operimit të tunelit dhe shërbimet e

kërkuara të mirëmbajtjes dhe funksionimit të pajisjeve të tij në bashkëpunim me ARRSH-në, Strukturat e Policisë, Brigadën e Shërbimit të Zjarrfiksave të Tunelit, si dhe gjithë autoritetet e tjera të përfshira për këtë qëllim. (fq.5). Menaxheri Primar i Operimeve në Tunel do të kontrollojë gjithë operimet në tunel dhe përreth tij, si dhe mirëmbajtjen e pajisjeve dhe sistemeve operuese të tunelit. Ai duhet që: Të koordinojë aktivitetet dhe të dhenat për operimin e tunelit, mirëmbajtjen e pajisjeve dhe sistemeve, policinë e tunelit dhe shërbimin kundër zjarrit, nëpërmjet trajnimeve nëse është e nevojshme, në mënyrë që të gjitha këto shërbime të funksionojnë sa më mirë, së bashku me organizatat dhe autoritetet e interesuara në funksionimin e tunelit, si dhe kundërpërgjigja ndaj situatave të emergjences;(fq.9) Operatorët Primarë të Tunelit duhet : Të marrin përsipër përgjegjësitë për kontrollin e vazhdueshëm për sigurimin e cilësise në të gjitha aspektet e operimit të tunelit, duke përfshirë veprimtaritë që kryen Policia e Shtetit dhe shërbimi zjarrfikës i tunelit gjatë gjithë kohës së turneve të tyre të punës; (fq.11).

Në vijim të sa më sipër kërkesa e vendosur nga Autoriteti Kontraktor për pajisjen me certifikatë “ekspert privat zjarrfikës” të një prej Drejtuesve Teknik të operatorit, jo vetëm që është kontradiktore dhe në kundërshtim me termat e referencës por është edhe e panevojshme duke marrë në konsideratë mënyrën e funksionimit të tunelit si dhe strukturat e ngritura dhe marrëveshjet ndërmjet tyre për ofrimin e këtij shërbimi. Gjithashtu theksojmë se në nenin 46 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, pika 1 përcaktohet; Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese.... Ky kriter nuk është në përputhje me rregullat e prokurimit publik pasi nuk i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes dhe kapacitetet ligjore, financiare, tekike apo kualifikimet e nevojshme, profesionale, kapacitetet organizative, e asete të tjera fizike të kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nevojiten për përmbushjen me sukses të kontratës si dhe nuk përmbush qëllimin për të cilin autoriteti kontraktor pretendon se është vendosur duke qenë se Autoriteti Kontraktor ka vendosur marrëveshje institucionale me Drejtorinë e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit për instalimin e njësisë së tyre (brigada e zjarrfiksave), e cila do të jetë përherë e instaluar në funksion të Tunelit. Kjo njësi është gjithë kohën në gjendje gadishmërie dhe e pajisur me gjithë elementët dhe kostot operuese të luftës kundër zjarrit në tunel, makinat zjarrfikse, shkurën kundra zjarrit, fikëset e zjarrit dhe pjesë të tjera konsumi. Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmgushje me sukses të kontratës dhe në rastin konkret kjo kërkesë është e panevojshme, dhe e pa justifikuar për më tepër e kërkuar për një nga Drejtuesit Teknik të Operatorit. Kërkesa e sipërcituar është absurde.

Së treti: Në dokumentat e tenderit dhe specifikisht “Kriteret për Kualifikim” kërkohet: *Stafi i pikave d,e,f duhet të rezultojë i siguruar në listëpagesat e kërkuara. Të paraqiten: diplomat dëshmitë/certifikatat e sipërpërmendura dhe listëpagesat përkatëse. Duke qenë se lidhur me “listëpagesat përkatëse” nuk përcaktohet ndonjë periudhë kohore që duhet të paraqitet është e mjaftueshme vetëm listëpagesa e muajit të fundit ?! Nëse po ku do të jetë e pasqyruar eksperiencia e stafit kryesor ?

Së katërti: Në dokumentat e tenderit dhe specifikisht “Kriteret për Kualifikim” kërkohet: c Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë: a) Licencë profesionale të shoqërisë për zbatim të punimeve, të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore, me kategoritë:

NP4/G (Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale)

NP-11/A (Ndërtim për n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë)

NS-5/A (Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut)

NS-12/A (Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit)

NS-13/A (Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni)

NS-14/A (Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj)

Klasifikimi G i kategorisë NP-4 i cili është për vlera mbi 800 milionë lekë nuk ka fare lidhje me objektin e procedurës. Nuk justifikohet as kategoria dhe as klasifikimi G. Nisur nga kërkesat e mësipërme ka ngjashmëri me kriteret për rrugë dhe jo mirëmbajtje dhe operim tuneli. Mospërputhja e kriterëve për kualifikim me termat e referencës dhe preventivin përvese krijon konfuzion dhe paqartësi në përgatitjen e ofertës devijon edhe nga objekti i procedurës i cili është shërbim dhe jo punë. Duke analizuar në kompleks këtë procedurë të prokuruar edhe më parë, ka ndryshime në vecanti për kërkesat e stafit, të cilët nuk kërkohen të siguroar referuar periudhës së kërkuar për listëpagesat, nuk specifikohet angazhimi i tyre vetëm për këtë kontratë dhe ndryshimi i paarsyetuar i tyre e bën të paqartë procesin. [...]”

II.3. Referuar dokumentacionit të administruar pranë KPP, në funksion të hetimit administrativ për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka trajtuar ankesën dhe i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues nëpërmjet shkresës nr. 2279/3 prot., datë 15.03.2019, duke e pranuar pjesërisht atë, me argumentimin si më poshtë vijon:

“[...]III.1 Referuar pretendimit të parë të ankimuesit, sipas të cilit në kërkesat për kualifikim ndër të tjera kërkohet 21 punonjës, ndërkohë që në termat e referencës kërkohen 37 punonjës. në preventivin që do të ofertohej kërkohen 37 punonjës, theksojmë se autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar në asnjë pikë të kriterëve për stafin 21 punonjës. Nuk është e qartë nëse ankimuesi i referohet pikës 3.3/c të kriterëve të veçanta (numrit mesatar të punonjësve të siguruar), sipas së cilës nëse do të kishte pretendime do të jepte argumentet e tij apo pretendimet për numrin e punonjësve të kërkuar. Në këto kushte, kjo pikë e ankesës nuk merret në shqyrtim.

III.2 Sa i përket pretendimit të dytë, mbi kërkesën: Kandidati/ofertuesi duhet të dëshmojë se të paktën një nga drejtuesit teknikë është i pajisur me certifikatë si 'Ekspert privat zjarrfikës'. të lëshuar nga Drejtoria e PMNZH (Ministria e Brendshme), Komisioni i shqyrtimit të ankesës gjykon se kjo nuk përbën një kërkesë të tepruar nga ana e AK-së. Duke pasur parasysh rëndësinë e veçantë të objektit të prokurimit, llojin e tij (operim i pajisjeve të tunelit) dhe duke qenë se rreziku primar dhe më i madh në të tilla objekte është pikërisht rënia e zjarrit, kjo pikë e ankesës nuk merret parasysh.

III-3 Në lidhje me pikën e tretë, ku kërkohet periudha kohore e listëpagesave të kërkuara, sqarojmë operatorin ekonomik se, referuar DST-ve të procedurës, ky informacion gjendet në pikën 3.3/c (numri mesatar i punonjësve të siguruar) të kriterëve të veçanta të kualifikimit.

III.4 Në lidhje me pikën e katërt, ku paraqitet pretendimi për pikën e licencës së kërkuar me kategori NP-4 G (Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale), mbështetur në VKM-në nr.42 datë 16.01.2008, komisioni arriti në konkluzionin kategoria rrugë-autostrada nuk mund të përjashtohet pasi është bazë për objekte të tilla por, referuar fondit limit të objektit që po prokurohet, kategoria e përshtatshme është: NP-4 D (për vlera nga 101-200 milionë lekë). Në këto kushte, komisioni vendosi që kjo pikë e kriterit të veçantë në kategorinë e licencave të kërkuara të jetë NP-4 D (dhe të reflektohet në dokumentet e tenderit). [...]"

II.4.Në datën 27.03.2019 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.5.Në datën 11.04.2019, nëpërmjet shkresës me nr.3330/1prot., datë 09.04.2019, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik "Ed-Konstruksion" sh.p.k.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, informacionit dhe dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se: "Së pari: Pasi u njohëm me dokumentat e tenderit dhe specifikisht "Kriteret për Kualifikim" konsatuam se ato nuk përputhen me kriteret e kërkuara në "Termet e Referencës". Në kërkesat për kualifikim të dokumentave të tenderit ndër të tjera kërkohet (21 punonjës):

e)Në Stafin kryesor kërkohen:

- 1 Menaxher Primar Drejtues për operimet në tunel/Oficer Sigurie: i diplomuar në inxhinieri transporti/infrastrukturë transporti

- 3 Operatorë primarë tuneli: të diplomuar në inxhinieri mekanike/elektrike

- 1 përgjegjës të mirëmbajtjes së pajisjeve: i diplomuar në inxhinieri elektrike/ mekanike.

f)Në stafin jokryesor:

- Jo më pak se 6 operatorë tuneli, të diplomuar në inxhinieri elektrike /elektronike/ mekanike.

- Të paktën 20 punonjës të kualifikuar, të certifikuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik e Industrial ose institucione të tjera të akredituara, ndër të cilët së paku: 4 elektrikistë, 2 hidraulikë, 2 mekanikë, 3 manovratorë mjetesh të rënda, 7 shoferë, 2 specialistë për kondicionim/aspirim.

- Kandidati/ofertuesi duhet të dëshmojë se të paktën një nga drejtuesit teknikë është i pajisur me certifikatë si 'Ekspert privat zjarrfikës', të lëshuar nga Drejtoria e PMNZH (Ministria e Brendshme) *Stafi i pikave d,e,f duhet të rezultojë i siguruar në listëpagesat e kërkuara.

Të paraqiten: diplomat/dëshmitë/certifikatat e sipërpërmendura dhe listëpagesat përpatëse.

Ndërkohë në termat e referencës kërkohet 37 punonjës :

Staf kyç në menaxhimin e tuneli , do të jenë:

-Një Menaxher Primar i Operimeve në Tunel / Oficer për Sigurinë duhet të ketë edukimin arsimor në inxhinieri transporti ose të infrastrukturës së transportit si dhe eksperiencë të paktën 5 vjeçare në sigurinë rrugore, veçanërisht në administrimin e incidenteve rrugore dhe inspektimin e sigurisë rrugore. Ai gjithashtu duhet të ketë njohuri për sistemet inteligjente të transportit që lidhen me administrimin e incidenteve e të aksidenteve rrugore

- Tre Operatorë Primarë Tuneli me edukim arsimor në inxhinieri mekanike, elektrike dhe eksperiencë të paktën 5 vjeçare në zhvillimin e shfrytëzimin e operacioneve në tunele rrugore dhe procedurave të mirëmbajtjes në to.

- Përgjegjës i Mirëmbajtjes së Pajisjeve, me arsimin inxhinieri elektrike ose mekanike, (me experiencë të mjaftueshme dhe të suksesëshme në tunele e vepra të tjera të natyrës së ngjashme) i cili do jetë përgjegjës për të siguruar standartin e duhur të cilësisë së mirëmbajtjes të pajisjeve dhe sistemeve të tunelit.

–Menaxheri i Tunelit duhet të punesojë Staf të trajnuar, që të bëhen kështu gjashtë Operatorë Lokalë Tuneli. Kërkohet që stafi i trajnuar të ketë staf mbështetës për sistemin e punës me turne, por këta të fundit gjithmonë do drejtohen nga Menaxheri Primar Tunelit në detyrë dhe në kontroll të turnit operues të radhës.

Gjithashtu, Menaxheri i Tunelit duhet të ketë Staf Jo-Kryesor (mbështetës) minimalisht si më poshtë: •4 Teknikë Mirëmbajtje Pajisjesh, të kualifikuar mjaftueshëm dhe me eksperiencë, që do trajnohen dhe drejtohen nga Përgjegjësi i Mirëmbajtjes së Pajisjeve, gjatë rrjedhës së kontratës, sipas Planit të Sigurimit të Cilësisë së mirëmbajtjes së pajisjeve që do operojnë në tunel. • 1 Menaxher Personeli i cili do të menaxhojë burimet njerëzore të Menaxherit të Tunelit si edhe financën e kësaj Kontratë; • 1 Asistent në pozicionin e Sekretarit/ Magazinjer • 4 Elektracistë të specializuar të cilet do të operojnë nga 1 në çdo turn 8-orarësh dhe 1 do të jetë zëvendësues, për çdo situatë; • 2 Mekanikë të specializuar të cilët do të mbulojnë situatat e pajisjeve mekanike të tunelit; • 2 Hidraulikë të specializuar të cilët do të mbulojnë situatat në hidrantët dhe pajisjet e tjera hidraulike të tunelit; 3 Shoferë për auto-vinc me kovë dhe karrotrec, nga 1 për çdo turn, • 8 shoferë për 4 kamionët pick-up apo fuoristrada të instaluar në tunel • 1 Pastruese për ambientet e Qëndres së Kontrollit;

Stafi mbështetës duhet të përfshihet në Ekipet e Mirëmbajtjes dhe Operimin të Tunelit. Kualifikimi dhe eksperiencia e stafit mbështetës duhet të prezantohet në Propozimin Teknik të Menaxherit të Tunelit, pavarësisht se stafi mund të mos limitohet në sasi të përkrahura më sipër por edhe të zgjerohet më tej numrit të përcaktuar në kriteret. Megjithatë, insuficensa e kualifikimit të nevojshëm të stafit mbështetës do të çojë edhe në refuzim të Propozimit Teknik. Menaxheri i Tunelit do përfshijë në Propozimin Financiar gjithë stafin e plotë të tij (si stafin kryesor dhe atë mbështetës). Menaxheri i Tunelit duhet të paraqesë detajet e stafit të tij për këtë Kontratë, sikurse është përcaktuar në Dokumentat e Tenderit. Ndërsa në preventivin në do të ofertohej në termat e referencës kërkohet 37 punonjës...” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën nr.8, pikat 3.3.e dhe 3.3.f “Kapaciteti teknik”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“e)Në Stafin kryesor kërkohen:

- 1 Menaxher Primar Drejtues për operimet në tunel/Oficer Sigurie: i diplomuar në inxhinieri transporti/infrastrukturë transporti

- 3 Operatorë primarë tuneli: të diplomuar në inxhinieri mekanike/elektrike

- 1 përgjegjës të mirëmbajtjes së pajisjeve: i diplomuar në inxhinieri elektrike/ mekanike.

f)Në stafin jokryesor:

- Jo më pak se 6 operatorë tuneli, të diplomuar në inxhinieri elektrike /elektronike/ mekanike.

- Të paktën 20 punonjës të kualifikuar, të certifikuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik e Industrial ose institucione të tjera të akredituara, ndër të cilët së paku: 4 elektrikistë, 2 hidraulikë, 2 mekanikë, 3 manovratorë mjetesh të rënda, 7 shoferë, 2 specialistë për kondicionim/aspirim.

- Kandidati/ofertuesi duhet të dëshmojë se të paktën një nga drejtuesit teknikë është i pajisur me certifikatë si ‘Ekspert privat zjarrfikës’, të lëshuar nga Drejtoria e PMNZH (Ministria e Brendshme)

*Stafi i pikave d,e,f duhet të rezultojë i siguruar në listëpagesat e kërkuara.

Të paraqiten: diplomat/dëshmitë/certifikatat e sipërpërmendura dhe listëpagesat përpatëse.”

III.1.2. Në shtojcën “Terma Reference”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

“Stafi kryesor do të përfshijë: Bazuar në Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr 648 datë 22.07.2015 “ Për Miratimin e kriterëve të caktimit të Menaxherit , Oficerit të sigorisë e inspektorit të autorizuar dhe të metodologjisë së analizës së riskut për sigurinë e tuneleve rrugore” është e domosdoshme që: a. Drejtuesi Teknik i Subjektit Juridik, përgjegjës për menaxhimin e tunelit duhet të ketë edukimin arsimor në inxhinieri transporti ose infrastrukturë të transportit dhe të paktën 10 vjet eksperiencë në administrimin e trafikut. Staf kyç në menaxhimin e tunelit , do të jenë:

Një Menaxher Primar i Operimeve në Tunel / Oficer për Sigurinë duhet të ketë edukimin arsimor në inxhinieri transporti ose të infrastrukturës së transportit si dhe eksperiencë të paktën 5 vjeçare në sigurinë rrugore, veçanërisht në administrimin e incidenteve rrugore dhe inspektimin e sigorisë rrugore. Ai gjithashtu duhet të ketë njohuri për sistemet inteligjente të transportit që lidhen me administrimin e incidenteve e të aksidenteve rrugore.

Oficeri i Sigurisë kryen detyrat dhe funksionet e mëposhtëme: a) Siguron kordinimin dhe shërbimet e emergjencave dhe merr pjesë në përgatitjen e skemave operacionale. b) Merr pjesë në planifikimin, implementimin dhe vlerësimin e operacioneve të emergjencës. c) Merr pjesë në përcaktimin e skemave të sigurisë, specifikimin e strukturës, pajisjeve dhe veprimit në tunel. d) Verifikon që stafi operacional dhe shërbimet e emergjencave janë trajnuar dhe ai duhet të marrë pjesë në organizimin e stërvitjeve që do të mbahen në intervale të rregullta. e) Jep këshilla në administrimin për strukturat, pajisjet dhe shfrytëzimin e tuneleve. f) Verifikon që struktura e tunelit rrugor dhe pajisjet janë mirëmbajtur dhe riparuar g) Merr pjesë në vlerësimin e

incidentëve dhe aksidenteve sipas Nenit 6 (pika 3 dhe 4) të ligjit Nr 158/2013 “Për Sigurinë në Tunelet Rrugore”.

2. Tre Operatorë Primarë Tuneli me edukim arsimor në inxhinieri mekanike, elektrike dhe eksperiencë të paktën 5 vjeçare në zhvillimin e shfrytëzimin e operacioneve në tunele rrugore dhe procedurave të mirëmbajtjes në to.

3. Përgjegjës i Mirëmbajtjes së Pajisjeve, me arsimin inxhinieri elektrike ose mekanike, (me experiencë të mjaftueshme dhe të suksesshme në tunele e vepra të tjera të natyrës së ngjashme) i cili do jetë përgjegjës për të siguruar standartin e duhur të cilësisë së mirëmbajtjes të pajisjeve dhe sistemeve të tunelit.

4. Menaxheri i Tunelit duhet të punesojë Staf të trajnuar, që të bëhen kështu gjashtë Operatorë Lokalë Tuneli. Kerkohet që stafi i trajnuar të ketë staf mbështetës për sistemin e punës me turne, por këta të fundit gjithmonë do drejtohen nga Menaxheri Primar Tunelit në detyrë dhe në kontroll të turnit operues të radhës. Gjithashtu, Menaxheri i Tunelit duhet të ketë Staf Jo-Kryesor (mbështetës) minimalisht si më poshtë:

- 4 Teknikë Mirëmbajtje Pajisjesh, të kualifikuar mjaftueshëm dhe me eksperiencë, që do trajnohen dhe drejtohen nga Përgjegjësi i Mirëmbajtjes së Pajisjeve, gjatë rrjedhës së kontratës, sipas Planit të Sigurimit të Cilësisë së mirëmbajtjes së pajisjeve që do operojnë në tunel.*

- 1 Menaxher Personeli i cili do të menaxhojë burimet njerëzore të Menaxherit të Tunelit si edhe financën e kësaj Kontratë;*

- 1 Asistent në pozicionin e Sekretarit/ Magazinjer*

- 4 Elektracistë të specializuar të cilët do të operojnë nga 1 në çdo turn 8-orarësh dhe 1 do të jetë zëvendësues, për çdo situatë;*

- 2 Mekanikë të specializuar të cilët do të mbulojnë situatat e pajisjeve mekanike të tunelit;*

- 2 Hidraulikë të specializuar të cilët do të mbulojnë situatat në hidrantët dhe pajisjet e tjera hidraulike të tunelit;*

- 3 Shoferë për auto-vinc me kovë dhe karrotrec, nga 1 për çdo turn,*

- 8 shoferë për 4 kamionët pick-up apo fuoristrada të instaluar në tunel*

- 1 Pastruese për ambientet e Qëndres së Kontrollit;*

Stafi mbështetës duhet të perfshihet në Ekipet e Mirëmbajtjes dhe Operimin të Tunelit. Kualifikimi dhe eksperiencia e stafit mbështetës duhet të prezantohet në Propozimin Teknik të Menaxherit të Tunelit, pavarësisht se stafi mund të mos limitohet në sasi të përshkruara më sipër por edhe të zgjerohet më tej numrit të përcaktuar në kritere. Megjithatë, insuficensa e kualifikimit të nevojshëm të stafit mbështetës do të çojë edhe në refuzim të Propozimit Teknik. Menaxheri i Tunelit do përfshijë në Propozimin Financiar gjithë stafin e plotë të tij (si stafin kryesor dhe atë mbështetës). Menaxheri i Tunelit duhet të paraqesë detajet e stafit të tij për këtë Kontratë, sikurse është përcaktuar në Dokumentat e Tenderit.”

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”

Ndërsa në nenin 28/2 të VKM 914/2014 përcakohet se: “2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”

III.1.4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, si dhe pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, Komisioni vëren se, ky i fundit në asnjë rast nuk ngre pretendime mbi numrin e punonjësve të kërkuar, apo mbi specialitetet/profesionet e tyre, por ngre pretendime mbi mospërputhjen e kriterëve të vecanta të kualifikimit me termat e referencës. Nga verifikimi i kryer në dokumentat e tenderit dhe termat e referencës të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, Komisioni gjithashtu e konstaton mospërputhjen e kriterit të vecnatë të kualifikimit në shtojcën nr.8, pikat 3.3.e dhe 3.3.f “Kapaciteti teknik”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, me përcaktimet termave të referencës lidhur me numrin dhe specilitetet/profesionet që duhet të disponojë operatori ekonomik për zbatimin e kontratës objekt prokurimi, duke shkaktuar paqartësi të operatorët ekonomik të interesuar, mbi përmbushjen e kriterëve të kualifikimit.

III.1.5. Komisioni gjykon se, autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtëpërdrejtë me kriterin e vecantë të vendosur. Në rastin konkret, autoriteti kontraktor ka lënë vend për konfuzion, pasi ka mospërputhje ndërmjet termave të referencës dhe kriterit të vecantë të kualifikimit, duke përcaktuar kapacitete njerëzore të ndryshme që duhet të disponojë operatori ekonomik pjesëmarrës, në kundërshtim me nenin 28/2 të VKM 914/2014. Në këto kushte, Komisioni gjykon se, autoriteti kontraktor duhet të unifikojë kërkesat lidhur me disponueshmërinë e kapaciteteve profesionale/njerëzore, në mënyrë që të krijohet panoramë e qartë mbi kapacitetet e kërkuara, të mos krijohet konfuzion si tek operatorët ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi, ashtu edhe tek anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave gjatë procesit të shqyrtimit e të vlerësimit të ofertave duke mos krijuar hapësirë për vlerësim subjektiv. Vlen të theksohet se, kriteret e kualifikimit, nga autoriteti kontraktor duhet të përcaktohen të qarta, të sakta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, volumin dhe objektin e kontratës objekt prokurimi me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe jo diskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi, si dhe duke mos i dëmtuar pjesëmarrësit në këtë procedurë.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se: *“Në vijim të sa më sipër kërkesa e vendosur nga Autoriteti Kontraktor për pajisjen me certifikatë “ekspert privat zjarrfikës” të një prej Drejtuesve Teknik të operatorit, jo vetëm që është kontradiktore dhe në kundërshtim me termat e referencës por është edhe e panevojshme duke marrë në konsideratë mënyrën e funksionimit të tunelit si dhe strukturat e ngritura dhe marrëveshjet ndërmjet tyre për ofrimin e këtij shërbimi.”* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën nr.8, pika 3.3.f “Kapaciteti teknik”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“•Kandidati/ofertuesi duhet të dëshmojë se të paktën një nga drejtuesit teknikë është i pajisur me certifikatë si ‘Ekspert privat zjarrfikës’, të lëshuar nga Drejtoria e PMNZH (Ministria e Brendshme)”

III.2.2. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

III.2.3. Në nenin 38 të Ligjit Nr. 152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin” parashikohet se: *“Personat fizikë e juridikë detyrohen të:*

- a) zbatojnë dispozitat e parashikuara nga ky ligj dhe aktet e tjera nënligjore për sigurinë nga zjarri dhe shpëtimin;*
- b) marrin masa për parandalimin e pakësimit të zjarreve, me anë të mjeteve, sistemeve, pajisjeve të diktimit-sinjalizimit për shuarjen e zjarreve, gjatë kryerjes së aktivitetit të tyre”*

III.2.4. Në shtojcën “Terma Reference”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

“Menaxheri i Tunelit, sikurse shpjegohet edhe më lart, do të sigurojë shërbimet e kërkuara të menaxhimit/operimit të tunelit dhe shërbimet e kërkuara të mirëmbajtjes dhe funksionimit të pajisjeve të tij në bashkëpunim me ARRSH-në, Strukturat e Policisë, Brigadën e Shërbimit të Zjarrfikësve të Tunelit, si dhe gjithë autoritetet e tjera të përfshira për këtë qëllim.”

Oficeri i Sigurisë kryen detyrat dhe funksionet e mëposhtëme: a) Siguron kordinimin dhe shërbimet e emergjencave dhe merr pjesë në përgatitjen e skemave operacionale. b) Merr pjesë në planifikimin, implementimin dhe vlerësimin e operacioneve të emergjencës. c) Merr pjesë në përcaktimin e skemave të sigurisë, specifikimin e strukturës, pajisjeve dhe veprimit në tunel. d) Verifikon që stafi operacional dhe shërbimet e emergjencave janë trajnuar dhe ai duhet të marrë pjesë në organizimin e stërvitjeve që do të mbahen në intervale të rregullta. e) Jep këshilla në administrimin për strukturat, pajisjet dhe shfrytëzimin e tuneleve. f) Verifikon që struktura e tunelit rrugor dhe pajisjet janë mirëmbajtur dhe riparuar g) Merr pjesë në vlerësimin e

incidentëve dhe aksidenteve sipas Nenit 6 (pika 3 dhe 4) të ligjit Nr 158/2013 “ Për Sigurinë në Tunelet Rrugore”.

III.2.5. Në nenin 7 të Ligjit Nr 158/2013 “Për Sigurinë në Tunelet Rrugore” parashikohet se:

Oficeri i sigurisë

1. Për secilin tunel rrugor, menaxheri i tunelit, me aprovimin e autoritetit, emëron oficerin e sigurisë, i cili koordinon të gjitha masat parandaluese dhe mbrojtëse për sigurinë e përdoruesve të rrugës dhe stafit operacional të tuneleve rrugore. Oficeri i sigurisë mund të jetë nga stafi i tunelit ose shërbimet e emergjencës dhe është i pavarur për të gjitha çështjet e sigurisë të tunelit rrugor. Një oficer sigurie mund të kryejë detyrat dhe funksionet e tij te disa tunele.

Kriteret dhe kualifikimet për të qenë oficer i sigurisë përcaktohen me akt nënligjor në zbatim të këtij ligji.

2. Oficeri i sigurisë kryen detyrat dhe funksionet e mëposhtme:

a) siguron koordinimin me shërbimet e emergjencave dhe merr pjesë në përgatitjet e skemave operacionale;

b) merr pjesë në planifikimin, implementimin dhe vlerësimin e operacioneve të emergjencës;

c) merr pjesë në përcaktimin e skemave të sigurisë, specifikimin e strukturës, pajisjeve dhe veprimit në drejtim të tuneleve të reja dhe ato ekzistuese;

ç) verifikon që stafi operacional dhe shërbimet e emergjencave janë trajnuar dhe ai duhet të marrë pjesë në organizimin e stërvitjeve që do të mbahen në intervale të rregullta;

d) jep këshilla në administrimin për strukturat, pajisjet dhe shfrytëzimin e tuneleve rrugore;

dh) verifikon që struktura e tunelit rrugor dhe pajisjet janë mirëmbajtur dhe riparuar;

e) merr pjesë në vlerësimin e incidenteve dhe aksidenteve, sipas nenit 6, pikat 3 dhe 4 të këtij ligji

III.2.6.Referuar dispozitave ligjore të sipërcituara, termave të referencës të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, si dhe rëndësisë së objektit ku do të kryhet shërbimi objekt kontrate, Komisioni gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor se ofertuesi duhet të disponojë një person të certifikuar si ekspert privat zjarrfikës është në përputhje me objektin e kontratës objekt prokurimi, pasi pavarësisht Brigadës të Shërbimit të Zjarrëfiksive të Tunelit të stacionuar në afërsi të tunelit, stafi operacional dhe shërbimet e emergjencave duhet të jenë të trajnuar për cdo rast emergjence, ku ndër to janë edhe rastet e zjarrit. Gjithashtu, kontraktori merr pjesë në planifikimin, implementimin dhe vlerësimin e operacioneve të emergjencës, si dhe siguron koordinimin me shërbimet e emergjencave dhe merr pjesë në përgatitjet e skemave operacionale. Por, kërkesa e autoritetit kontraktor se, personi i certifikuar si ekspert privat zjarrfikës, duhet të jetë drejtues teknik i shoqërisë, është një kërkesë e ekzagjeruar dhe përtej asaj cka është e nevojshme për krijimin e besueshmërisë ndaj operatorit ekonomik pjesëmarrës, për zbatimin e me sukses të kontratës. Komisioni gjykon se, për autoritetin kontraktor është e nevojshme të sigurohet që operatorët ekonomik e disponojnë një kapacitet të tillë, por jo mënyra e disponimit dhe roli i tij në stafin e këtij të fundit. Vlen të theksohet se, kriteret e kualifikimit, nga autoriteti kontraktor duhet të përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi, volumin dhe objektin e kontratës objekt prokurimi me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe jo diskriminues, duke

mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi, si dhe duke mos i dëmtuar pjesëmarrësit në këtë procedure. Në këto kushte, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e sipërcituar, duke mospërcaktuar funksionin që kryen pranë operatorit ekonomik, personi i cili duhet të jetë i certifikuar si ekspert privat zjarrëfikës.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se: *“Së treti: Në dokumentat e tenderit dhe specifikisht “Kriteret për Kualifikim” kërkohet: *Stafi i pikave d,e,f duhet të rezultojë i siguruar në listëpagesat e kërkuara. Të paraqiten: diplomat dëshmitë/certifikatat e sipërpërmendura dhe listëpagesat përkatëse. Duke qenë se lidhur me “listëpagesat përkatëse” nuk përcaktohet ndonjë periudhë kohore që duhet të paraqitet është e mjaftueshme vetëm listëpagesa e muajit të fundit ?! Nëse po ku do të jetë e pasqyruar eksperiencia e stafit kryesor ?”* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në rastin konkret, Komisioni konstaton se ndodhemi para kërimit për sqarime mbi dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi. KPP gjykon se objekti i ankesës së operatorit ekonomik ankimues nuk lidhet me kundërshtimin e një vendimi të shprehur nga ana e autoritetit kontraktor (verifikimin ligjor në rast se kriteri kualifikues është në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës), por në thelb është një kërkesë për sqarim. Operatori ekonomik në ankesë, në asnjë rast nuk ka pretenduar modifikimin e kriterit të mësipërm, por ka shtruar në formën e një pyetje se ku do jetë e pasqyruar eksperiencia e stafit kryesor dhe se cila është periudha për të cilën duhen paraqitur listëpagesat e shoqërisë. Në këtë kuadër, KPP gjykon se në përputhje me nenin 42 të LPP i cili parashikon shprehimisht se: *Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]* Autoriteti kontraktor, në çdo kohë, përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë për sqarim nga një operator ekonomik, mund të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit, përmes hartimit të një shtojce. Çdo shtojcë u komunikohet menjëherë të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit dhe bëhet detyruese për ta. Shtojca vihet në dispozicion edhe në rrugë elektronike. 2/1. Në çdo rast, kur ndryshohen dokumentet e tenderit, autoriteti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me 5 ditë, ndërsa për prokurimet mbi kufijtë e lartë monetarë me 10 ditë.”, autoriteti kontraktor, me anë të shkresë kthim përgjigje nr. 2279/3 prot., datë 15.03.2019, ka bërë sqarimet e nevojshme për operatorin ekonomik ankimues vetëm lidhur me periudhën për të cilën dueht të paraqiten listëpagesat e shoqërisë, por në zbatim të nenit 42 pika 2 të L.P.P-së, autoriteti kontraktor, duhet

të sqarojë ankimuesin për çdo paqartësi, e më pas këtë sqarim duhet ta publikojë në Sistemin e Prokurimeve Elektronike.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se: *“[...]Klasifikimi G i kategorisë NP-4 i cili është për vlera mbi 800 milionë lekë nuk ka fare lidhje me objektin e procedurës. Nuk justifikohet as kategoria dhe as klasifikimi G. Nisur nga kërkesat e mësipërme ka ngjashmëri me kriteret për rrugë dhe jo mirëmbajtje dhe operim tuneli. Mospërputhja e kriterëve për kualifikim me termat e referencës dhe preventivin përvecse krijon konfuzion dhe paqartësi në përgatitjen e ofertës devijon edhe nga objekti i procedurës i cili është shërbim dhe jo punë”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në shtojcën nr.8, pika 3.3.a “Kapaciteti teknik”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“a)Licencë profesionale të shoqërisë për zbatim të punimeve, të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore, me kategoritë:

-NP- 4/G (Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale)

-NP- 11/A (Ndërtim për n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë)

-NS - 5/A (Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut)

-NS - 12/A (Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit)

-NS - 13/A (Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni)

-NS - 14/A (Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj)

**Shoqëritë e huaja, në lidhje me ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës, t'i referohen VKM- së Nr.42 Datë 16.01.2008, e ndryshuar”*

III.4.2.Në kthim përgjigjen e autoritetit kontraktor, lidhur me trajtimin e ankesës, konstatohet se komisioni i shqyrtimit të ankesës ka vendosur si më poshtë vijon:

“III.4 Në lidhje me pikën e katërt, ku paraqitet pretendimi për pikën e licencës së kërkuar me kategori NP-4 G (Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale), mbështetur në VKM-në nr.42 datë 16.01.2008, komisioni arriti në konkluzionin kategoria rrugë-autostrada nuk mund të përjashtohet pasi është bazë për objekte të tilla por, referuar fondit limit të objektit që po prokurohet, kategoria e përshtatshme është: NP-4 D (për vlera nga 101-200 milionë lekë). Në këto kushte, komisioni vendosi që kjo pikë e kriterit të veçantë në kategorinë e licencave të kërkuara të jetë NP-4 D (dhe të reflektohet në dokumentet e tenderit).”

III.4.3. Në Vendimin nr. 42, datë 16.01.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, jepen shpjegimet për kategoritë e ndërtimeve (punimeve) të përgjithshme, ku përcaktohet: *“N.P. 4 Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale.*

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet në nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tranvai, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrale dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të paranderur, parafabrikat ose të prodhuar në objekt. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi “goma”, “hekur”, “zona”, kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore.

III.4.4. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

III.4.5. Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, mbi modifikimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është me vend të ndalet në një test balancues të dy elementëve kryesorë. Së pari, nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. Gjithashtu, në shqyrtimin e kriterit të mësipërm të kualifikimit, K.P.P. gjykon të ndalet edhe në faktin nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së.

III.4.6. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zotërojnë kapacitetin teknik e konkretisht licencë profesionale të shoqërisë për realizimin e shërbim/mirëmbajtjes, ku të përfshihen kategoritë e përkatëse të licencës sipas shërbimeve/punëve që do të kryejnë sipas preventivit dhe termave të referencës. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se referuar preventivit të punimeve, si dhe termat e referencës, autoriteti kontraktor në asnjë rast nuk ka përcaktuar se kontraktori duhet të bëjë mirëmbajtje të karakterit ndërtimor sipas përcaktimeve në Vendimin nr. 42, datë 16.01.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, ku jepen shpjegimet për kategoritë e ndërtimeve (punimeve) të përgjithshme, dhe përcaktohet: “Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi “goma”, “hekur”, “zona”, kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore. KPP gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor mbi zotërimin e kapacitetit teknik e konkretisht licencë profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, ku të përfshihet

kategorita e punimeve NP-4 Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale, nuk është në përputhje me objektin e kontratës që prokurohet dhe përtej asaj cfarë është e nevojshme për të arritur synimin lidhur me njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë. Në këto kushte, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e mësipërm duke hequr kërkesën për disponimin e kategorisë NP-4 në licencën profesionale.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Ed-Konstruksion” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me objekt “*Menaxhimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve dhe operimi i Tunelit të Krrabës*”, me nr. REF-12661-03-06-2019, me fond limit 194,920,000 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Ed-Konstruksion” sh.p.k.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 535 Protokolli, Datë 27.03.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha